

V E N D I M
Nr.518, datë 14.11.1999

**PËR MIRATIMIN E PUBLIKIMIT TË KËRKESËS PËR SHPALLJEN E
SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË ZË
REHABILITIMI I AKSIT RRUGOR "DURRËS - RROGOZHINË".**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994, "Për shpronësimin për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme", me propozimin e Ministrisë së Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e publikimit të kërkesës për shpalljen e shpronësimit për interes publik të pasurive të paluajtshme, 11 026 m² truall, 65 789 m² tokë bujqësore, që zë rehabilitimi i aksit rrugor "Durrës - Rrogozhinë".

2. Listat emërore të pronarëve të këtyre pasurive, që do të shpronësohen, së bashku me sipërfaqet përkatëse të shpronësimit, i bashkëlidhen vendimit.

3. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta